



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1863/5 prot

Datë. 22.07.2024

V E N D I M

Nr. 928/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2024 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes së ankesës së operatorit ekonomik “Mektrin Motors” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-11172-06-26-2024, me objekt: “*Loti 1 ‘Blerje automjetesh të kalueshmërisë së lartë’*”, me fond limit 16 511 111 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.3, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Mektrin Motors” SHPK, me NUIS K51408501P dhe adresë: Autostrada Durrës - Tiranë, Km 6, Xhafzotaj.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit*”

Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.06.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-11172-06-26-2024, me objekt: “*Loti I ‘Blerje automjetesh të kalueshmërisë së lartë’*”, me fond limit 16 511 111 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 08.07.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4312, protokolluar me nr. 1863/2024 prot., date 08.07.2024, e operatorit ekonomik “*Mektrin Motors*” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 17.07.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1863/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 648/11 prot., datë 16.07.2024, me objekt: “Dërgim - vendimi”, drejtuar operatorit ekonomik ankimues dhe KPP-së, bashkëngjitur Vendimi me nr. 648/10 prot., datë 15.07.2024 i KSHA-së, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Mektrin Motors” SHPK.

II.5. Referuar Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me nr. 648/10 prot., datë 15.07.2024, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-11172-06-26-2024, me objekt: “Loti 1 Blerje automjetesh të kalueshmërisë së lartë”, me fond limit 16 511 111 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me nr. 648/10 prot., datë 15.07.2024, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;*
 - ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*
 - b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*
 - c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*
- 3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*
- a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*
 - b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”*

III.1.4. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës me nr. 648/11 prot., datë 16.07.2024, të autoritetit kontraktor, me objekt: “Dërgim - vendimi”, protokolluar në KPP me nr. 1863/2 prot., datë 17.07.2024 dhe Vendimit të KSHA-së me nr. 648/10 prot., datë 15.07.2024, bashkëngjitur kësaj shkrese, KPP-ja konstaton, se autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, e ka pranuar tërësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative, për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mektrin Motors” SHPK .

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “Mektrin Motors” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-11172-06-26-2024, me objekt: “*Loti 1 ‘Blerje automjetesh të kalueshmërisë së lartë’*”, me fond limit 16 511 111 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.
 3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mektrin Motors” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

